



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

PLK. D. nr. 642/23

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT, i përbërë nga Valdete Daka, kryesuese e Panelit, Burim Ademi dhe Ruzhdi Osmani, anëtarë të panelit, me pjesëmarrjen e Mersime Mehmeti, u.d. koordinatorë të panelit, duke vendosur përkitazi me kërkesën e datës 30.10.2023, për lirim me kusht, të parashtuar nga S. H., për shkak të veprës penale në vazhdim Marrja e ryshfetit nga neni 428 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000€, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.69/2017, i datës 30.06.2021, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.405/21, i datës 08.11.2021, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117, 118 dhe 119 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 13, 14, 25 pika 1.1 si dhe nenit 35 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 01/39) mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur me datë 04.12.2023, në selinë e KGJK-së në Prishtinë, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET kërkesa për lirim me kusht për të dënuarin S. H. nga i ati Xh. dhe e ëma Z., e gjinisë B., i lindur me datë ..., në fshatin T., Komuna S., me vendbanim në fshatin K. e U., Komuna S., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. S. H. do të lirohet me dt. 08.12.2023, dhe do të jetë nën mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues të Kosovës deri me dt. 29.04.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.69/2017, i datës 30.06.2021, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.405/21, i datës 08.11.2021, S. H. është shpall fajtor për shkak të veprës penale në vazhdim Marrja e ryshfetit nga neni 428 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000€.

Paneli për lirim me kusht, në seancën e mbajtur me datë 4 dhjetor 2023, me rastin e shqyrtimit të kërkesës, ka shqyrtuar raportin përmbledhës të përpiluar nga ekipi profesionist i Shërbimit korrektues të Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 par. 6 të Ligjit Nr. 08/ L – 132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave të paraqitura në shkresat e cekura më lartë, paneli ka gjetur se:

Në raportin ligjor për të dënuarin është konstatuar se lirimi normal për të dënuarin është caktuar me datë 29.04.2024 dhe nga llogaritja e dënimit rezulton se i dënuari deri më tani i ka vuajtur 1 vit, 7 muaj, 5 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 4 muaj, 25 ditë, të cilat do të mbikëqyren dhe kontrollohen nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Paneli gjatë shqyrtimit të dosjes i ka vlerësuar edhe raportet e tjerë të përpiluara nga Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, në të cilat është konstatuar se i dënuari gjatë vuajtjes së dënimit ka treguar sjellje dhe qëndrim të mirë, shfrytëzues i beneficionit të punësimit dhe pushimit të rregullt jashtë Institucionit Korrektues. Sa i përket qëndrimit ndaj veprës penale, i dënuari e pranon dhe ndjehet i penduar duke premtuar se më nuk do të përsëris gabime të tilla. Nga Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, është konstatuar se i dënuari ka arritur shkallë të lartë të risocializimit, ku tani është i gatshëm që të riintegrohet në shoqëri si person i dobishëm.

Paneli konstaton se sjellja e mirë e të dënuarit gjatë mbajtjes së dënimit, shfrytëzimi i beneficioneve të punësimit dhe pushimit të rregullt jashtë Institucionit Korrektues, shkalla e lartë e risocializimit dhe koha e mbetur në përpjesëtim me kohën e vuajtur ngase ky person ka vuajtur më shumë se 2/3 e dënimit që nga data 29.08.2023, ka arritur qëllimin e dënimit të paraparë sipas nenit 5 dhe 6 të LESP-së lidhur me nenin 38 të KPRK-së. Po ashtu, gjatë vlerësimit të kërkesës për lirim me kusht ka vlerësuar edhe premtimin e dhënë zyrtarit të Shërbimit Sprovues të Kosovës se do të bashkëpunojë me këtë shërbim deri në përfundimin e mbikëqyrjes së lirimit me kusht dhe se me një mbikëqyrje efektive e dënuara me lehtësi do të ri-integrohet në familje dhe shoqëri në pajtim me ligjin.

Paneli vendosi që ta lirojë me kusht personin e dënuar S. H., ai do të lirohet me kusht me dt. 08.12.2023 (e premtë ora 16:00), nën kushtet e mëposhtme:

Brenda pesë (5) ditësh nga data e lirimit nga burgu të lajmërohet në Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kosovës, përkatësisht të Shërbimit Sprovues:

1. të raportojë rregullisht në Shërbimin Sprovues deri me 29.04.2024;
2. në rast të ndërrimit të vendbanimit ta njoftoj policinë dhe Shërbimin Sprovues;
3. të mos tentojë që të udhëtojë jashtë shtetit, pa miratimin e Panelit për Lirim me Kusht;
4. të jetë me i kujdesshëm me sjelljet e tij në të ardhmen.

Udhëzim për Qendrën Korrektuese:

Qendra Korrektuese ku personi i dënuar është duke vuajtur dënimin duhet të ndërmarr veprimet si në vijim:

- I.** kompletin Aneksin 2 – Komunikimi i Lirimit me Kusht Gjykatës kompetente;
- II.** kompletin Aneksin 2a – Komunikimi i Lirimit me Kusht Policisë;
- III.** kompletin Aneksin 2b – Komunikimi i Lirimit me Kusht Shërbimit Sprovues;
- IV.** i shpjegon plotësisht personit të dënuar kushtet e lirimit (obligimet ligjore mbi zbatimin e vendimit - kushtet mbi raportimin dhe pasojat e krimeve tjera).

Udhëzim për Drejtorinë Regjionale të Shërbimit Sprovues:

Drejtoria Regjionale e Shërbimit Sprovues duhet të ndërmarr veprimet si në vijim:

- I. Drejtoria përkatëse regjionale e Shërbimit Sprovues duhet që të raportoj jo më larg se tri (3) javë nga data e lirimit të të dënuarit, gjithashtu e mban të informuar panelin me raporte periodike deri në skadimin e kohës së rregullt të dënimit.
- II. Zyrtari Sprovues udhëzohet që të fokusohet mbi orientimin e të liruarit me kusht në kuptim të respektimit të kushteve të caktuara sipas aktvendimit të panelit. Duke u bazuar në kohën e lirimit të zakonshëm të dënimit për të dënuarin, ai do lirohej me datë 29.04.2024. Rekomandohet që i liruari të mban me vete aktvendimin mbi lirimin me kusht gjatë tërë kohës deri në skadimin e lirimit të tij me kusht, që është caktuar me 29.04.2024.

Personi i cili është liruuar me kusht është i njoftuar me faktin se:

- Lirimi me kusht mund të revokohet, dhe në disa raste duhet të revokohet, nëse i dënuari, gjatë lirimit me kusht kryen një apo me shumë vepra penale, neni 91 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Kodi nr. 06/L-074;
- I liruari me kusht është i obliguar që të njoftoj Policinë dhe Shërbimin Sprovues brenda 5 (pesë) ditëve të lirimit, për vendqëndrimin e përkohshëm të tij apo saj gjatë periudhës së lirimit me kusht;
- Gjithashtu personi i liruuar me kusht është i obliguar që të raportoj në Shërbimin Sprovues gjatë periudhës së lirimit me kusht;
- Nëse i liruari me kusht e ndërron vendbanimin, është i obliguar që të njoftoj Policinë dhe Shërbimin Sprovues;
- Nëse dështon të informoj apo raportoj siç u përmend me lartë, paneli mund t'a revokoj vendimin për lirim me kusht, neni 119 paragrafi 4 i Ligjit rr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me nenin 36 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 39) mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht;
- Gjithashtu nëse dështon që të raportoj para SHSK-së siç përcaktohet në vendim, paneli mund ta revokoj vendimin për lirim me kusht (neni 119 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale).

Nga sa u tha si më lartë, në bazë të nenit 25 pika 1.1 të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT PLK. D. nr. 642/23, dt. 04.12.2023

U.d. Koordinatore e Panelit

Mersime Mehmeti

Kryesuese e Panelit

Valdete Daka

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.